



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:108435

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03216630

PKR.nr.100/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti për Krime të Rënda, me gjyqtarin Naser Maliqi, me zyrtaren ligjore Zahide Rexhepi, në qështjen penale kunder të pandehurit L.A, ngaKomuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit , shkurrës së kokainës ose bimëve së kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-Së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokuroris Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.130/2022 të datës 20.05.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 21.06.2022 mori dhe shpalli punlikisht ndërsa perpiloi me datën 21.06.2022 këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri L.A nga babai Xh. dhe ëma M. e gjinisë S, i lindur me datën ... në Gjilan, me vendbanim në ... Komuna e Gjilanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i një fëmije i gjendës së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTE FAJTORE

SEPSE

Me datë 17.05.2022 në fshatin ...Komuna e Gjilanit, i pandehuri në mënyr të kundërligjshme ka kultivuar pa autorizim bimën e hashashit, shkurrës së kokainës ose bimës së kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotrope, ashtu që gjatë kontrollimit të shtëpisë së të pandehurit rreth orës 9;10=10;30 nga ana e njësitit anti drogë, në një vazë

në oborrin e shtëpisë është gjetur dhe sekuestruar një bimë e dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa në gjatësi prej 1meter e 20cm

- Me këtë ka kryer vepren penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurr së kokainës ose bimëve së kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së

Andaj në bazë të neneve 4,38,39,40,42, 46,47 48,49,50,69,70, 71,72 te KPRK-se

E GJYKON

Me denim me burg ne kohezgjatje prej 90 ditesh, I cili denim nuk do te ekzekutohet me kusht, qe ne afat prej 1 (nji) viti most e kryej veper tjeter penale, ne te kunderten do te revokohet kushti.

Obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate t'i paguajë shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi .

Konfiskohet: substanca narkotike e llojit kanabis sativa në gjatësi prej 1 meter e 20 cm.

A R S Y E T I M

Prokuroria THemelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda me datën 30.05.2022 ka ngritur aktakuzë PP,I,nr 130/2022 ndaj të pandehurit L.A nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale kultivimi I bimës së hashashit, shkurrës së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së

Kryetari I trupit gjykues me datën 21.06.2022 ka mbajtur seancen e shqyrtimit fillestar, në të cilën është lexuar aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit , ndërsa e I akuzuari L.A e ka pranuar fajësin për veprat penale e cila I vihet në barrë, duke kërkuar falje, dhe duke premtuar se nuk do t'i përsëris vepren penale.

Gjykata pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit dhe avokatit mbrojtës, ka aprovuar pranimin e fajësisë, sepse ky pranim ka qenë vullnetar, I pandehuri I ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe se ky pranim ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës; Raporti fillestar I incidentit, kërkesë për ekzaminimin e bimës narkotike, raport njoftues për test fushor, raport njoftues lidhur me bastisjen, procesverbal për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm, vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, procesverbal mbi marrjen

në pyetje të pandehurit në polici dhe prokurori, raport I këqyrjes së vendit të ngjarjës, informacionet e personit, raport I shpejtë, konfirmimi I kërkesës për veprime hetimore si dhe shkresa tjera të lëndës

Gjatë matjes dhe shqiptimit të denimit, gjykata ka pasur parasysh sjelljen e mire të të pandehurit në gjykatë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pa asnjë hezitim, pendimin e të pandehurit, premtimin se nuk do të përsëris vepren penale.

Gjykata ka detyru të pandehurën që të paguaj shumën prej 20 euro në emër të paushallit gjyqsor, ndërsa substance narkotike është konfiskuar.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti për Krime të Rënda

Me datë 21.06.2022

Zyrtare ligjore:
Zahide Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues:
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij akgykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:108435
Datë: 12.07.2022
Numri i dokumentit: 03216630